



Primitje / Dorëzuar Received / Submitted Received / Electronically	10.03.2022	2	Vite Years
Grupi / Klasa Organ / Kategorija Eng. / Class	No. Punt De. Punt Post. No.	Shkalla Punë Appendix	Sasia Kopime Quantity
SKIPINSKI	1273/2022		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.60/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.60/2022, të datës 25.01.2022, të ankuesit me adresë banimi:

Prishtinë, kundër organit të punësimit Komisioni Qendror Zgjedhor, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.03.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.60/2022 e datës 25.01.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 06-2022 i datës 06.01.2022 i Kryeshefit Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor për anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar i Listës Votuese me numër reference KQZ-32/2021 si dhe Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror Zgjedhor me numër: 3549-2021 i datës 30.12.2021.
- III. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, ta zbatojë këtë vendim duke i bërë lëshimin e Akt Emërimit për ankuesin në pajtim me dispozitat ligjore.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave.

Arsyetim

Komisioni Qendror Zgjedhor, me datë 11.10.2021, ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar i Lartë i Listës Votuese" me numër reference KQZ-32/2021, ndërsa kandidati pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit [redacted] ka parashtruar ankesë me datë 30.11.2021 dhe plotësim ankesën e datës 01.12.2021 në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror Zgjedhor me pretendimet ankimore lidhur me shkeljet administrative dhe procedurale të procedurës së rekrutimit dhe shkeljes së parimeve të meritës në procedurën e rekrutimit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror Zgjedhor, me datë 30.12.2021 ka nxjerr vendimin me numër protokoll 3549-2021, me të cilin e ka aprovuar ankesën e ankuesit [redacted] duke anuluar konkursin për pozitën "Zyrtar i Lartë i Listës Votuese", ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datën 06.01.2022 ka nxjerr vendim me numër protokoll 06-2022 dhe e ka anuluar konkursin me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Ankuesi [redacted] pa pakënaqur me Vendimin për anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar i Listës Votuese" me numër reference KQZ-32/2021 të Kryeshefi Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, respektivisht kandidati më i vlerësuar në konkursin e shpallur, brenda afatit ligjor në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi më datë 25.01.2022 me numër protokoll 327/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit Qendror Zgjedhor me rastin e aprovimit të ankesës së ankuesit respektivisht nxjerrjen e vendimit për anulimin e konkursit kanë vepruar kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 31.01.2022, me numër protokoll 431/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendror Zgjedhor, ndërsa me datën 11.02.2022 me numër protokoll 698/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni Qendror Zgjedhor, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:327/2022 të datës 25.01.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs (rishpallje) për plotësimin e vendeve të lira të punës i datës 11.10.2021; Njoftim për vazhdimin e afatit të konkursit; Vendim me numër 2996-2021 i datës 08.11.2021; Raport nga Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën me numër të referencës KQZ-32/2021 Zyrtari i Lartë i Listës së Votuesve i datës 12.11.2021; Raport nga testimi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve

(KQZ-32/2021) i datës 19.11.2021; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 26.11.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form. KQZ-R-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form. KQZ-R-10; Vendim për anulimin e konkursit për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës Votuese me numër reference KQZ-32/2021 i datës 06.01.2021; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër 3549 i datës 30.12.2021; Rregullore nr.03/2017 për procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në sekretariatën e komisionit qendror të zgjedhjeve i datës 08.08.2017; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2022; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 10.02.2022; Përgjigje në ankesë e datës 10.02.2022; Kërkesë për fillimin e rekrutimit (punësimit) i datës 09.10.2021; E-mail nga V.B. për J.C. i datës 10.02.2022; E-mail nga V.B. për V.K. i datës 26.10.2021; E-mail nga V.B. për marketing@kohaditore.com i datës 26.10.2021; Regjistri i aplikacioneve të pranuar Form.KQZ-R-04; Kandidatët të cilët nuk e kanë kaluar testin me shkrim; Kandidatët të cilët e kanë kaluar testin me shkrim; E-mail nga V.B. për B.B. i datës 08.11.2021; E-mail nga B.B. për XH.P. i datës 17.11.2021; E-mail nga V.B. për V.B. i datës 16.11.2021; E-mail nga B.B. për XH.P. i datës 22.11.2021; Data e testimit me shkrim 18.11.2021; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj forma.KQZ-R-07a; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Dëshmi nga Trusti për L.K. i datës 13.11.2002-18.10.2021; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës për L.K. me numër reference 12/11992 i datës 27.09.2016; Vërtetim për kryerjen e praktikës i L.K. i datës 13.01.2017; Vërtetim nga SKQZ për L.K. e vitit 2021; Vërtetim nga SKQZ për L.K. i datës 31.12.2017; Vërtetim nga SKQZ për L.K. i datës 10.07.2014; Certifikatë nga IKAF për L.K. i datës 24.04.2019; Diplomë me nr.7040 e datës 11.10.2016; Diplomë me nr.1956 i datës 30.09.2019; Certifikatë nga Gjykata Themelore Prishtinë për L.K. i datës 15.10.2021; Kontratë mbi punën nga NP International Press për L.K. i datës 01.09.2016; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i personelit SKQZ për L.K. i datës 21.10.2021; Vërtetim nga SKQZ për L.K. i datës 21.10.2021; Certifikatë për A.B. i datës 17.03.2006; Marrëveshje për shërbime të veçanta e A.B. i datës 26.07.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta e A.B. i datës 13.01.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta e A.B. i datës 25.06.2016; Marrëveshje për shërbime të veçanta e A.B. i datës 25.03.2016; Marrëveshje për praktikë në punë për A.B. i datës 14.01.2016; Përshkrimi i detyrave të punës për A.B. i datës 18.01.2016; Marrëveshje për praktikë në punë për A.B. i datës 15.07.2015; Përshkrimi i detyrave të punës për A.B. i datës 15.07.2015; Marrëveshje për shërbime të veçanta e A.B. i datës 05.04.2018; Përshkrimi i detyrave të punës për A.B. i datës 05.04.2018; Marrëveshje për angazhim në masë aktive të tregut të punës praktikë në punë për A.B. i datës 05.06.2019; Përshkrimi i detyrave të punës për A.B. i datës 05.06.2019; Kërkesa për punësim e R.M.; CV-ja e R.M.; Letër motivuese e R.M.; Diplomë me nr.1693 e datës 14.12.2012; Diplomë me nr.1439 e datës 13.06.2017; Letër referencë nga Kryqi i Kuq i Kosovës për R.M. i datës 03.03.2017; Vërtetim nga Kryqi i Kuq i Kosovës për R.M. i datës 29.05.2017; Letër Rekomandim nga komanda e forcës tokësore për R.M. i datës 30.03.2012; Certifikatë për R.M. i datës 15.12.2013; Certifikatë nga Kryqi i Kuq i Kosovës për R.M. i datës 26.03.2014; Certifikatë nga Kryqi i Kuq i Kosovës për R.M. i datës 23.10.2008; Certifikatë nga ICRC për R.M. i datës 24.03.2011; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për R.M. i datës 26.08.2021; Vendim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i personelit SKQZ për R.M. i datës 22.10.2021; Kërkesa për punësim e A.B. i datës 22.10.2021; Diplomë me nr.2211 i datës 09.03.2012; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për A.B. i datës 21.10.2021; Rekomandim nga MPMS për A.B. i datës 16.03.2021;

Vërtetim nga MPMS për A.B. i datës 18.03.2021; Letër rekomandim për A.B. i datës 12.12.2010; Vërtetim për punësim i A.B. i datës 27.01.2014; Vërtetim nga biblioteka komunale Malishevë i A.B.; Certifikatë nga Ministria e Infrastrukturës për A.B. e muajit Janar 2021; Certifikatë për A.B. e muajit tetor 2020; Certifikatë për A.B.; Certifikatë për A.B. i datës 16.07.2006; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatit A.J.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatit B.M.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatës R.M.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatit L.K.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatës V.D.K.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatës V.O.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatit A.B.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatës B.K.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatës D.S.; Testi me shkrim për pozitën Zyrtar i Lartë i Listës së Votuesve i datës 18.11.2021 i kandidatit L.K.; Njoftim në lidhje me rekomandimin e Komisionit Përzgjedhës për Procedurën e Rekrutimit për pozitën e Zyrtarit të Lartë të Listës Votuese i datës 02.12.2021; Kërkesa për punësim i B.K. i datës 25.10.2021; Certifikatë nga Gjykata Themelore Pejë për B.K. i datës 05.07.2021 CV-ja e B.K.; Dëshmi nga trusti i datës 20.12.2010-20.10.2021; Letër Rekomandim nga KQZ për B.K. i datës 18.06.2020; Referencë për B.K. i datës 15.11.2017; Letër Rekomandim për B.K. i datës 03.12.2018; Vlerësim nga MASHT për B.K. i datës 08.11.2012; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës praktike në punë e B.K. i datës 05.01.2021; Certifikatë për B.K. e muajit Janar 2020; Certifikatë për B.K. e datës 14.05.2018; Certifikatë për B.K. e datës 12.03.2019; Certifikatë për B.K. e datës 21.02.2018; Certifikatë nga GIZ për B.K. e datës 18.07.2018; Certifikatë për B.K. e datës 09.12.2017; Certifikatë për B.K. e datës 27.10.2018; Certifikatë për B.K. e datës 25.03.2018; Certifikatë nga KVRL Shtime për B.K.; Certifikatë nga Europe Academy për B.K.; Diplomë me nr.ref 2483/12 i B.K. i datës 02.05.2012; Certifikatë nga shkolla computers kujtesa për B.K. e muajit 17.01.2017; Diplomë me numër nr.3633/1220 i datës 21.12.2020; Diplomë me numër nr.197/0513 i datës 27.05.2013; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ i datës 25.10.2021; Kërkesa për punësim e L.K. Kërkesa për punësim e A.O. e datës 25.10.2021; Certifikatë nga Gjykata Themelore Prishtinë për A.O. i datës 30.04.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës Bachelor i Shkencave Politike i A.O.; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës me numër 1426 i A.O.; Diplomë nga Kolegji Universum për A.O.; Vërtetim nga Universiteti i Prishtinës për A.B. i datës 29.01.2014; Certifikatë e Notave për A.B. i datës 03.11.2014; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ i datës 22.10.2021; Kërkesa për punësim e V.D.K.; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës për V.D. i datës 08.10.2011; Diplomë me numër 1071 e datës 23.05.2012; Diplomë me numër 711 e datës 22.07.2016; CV-ja e V.D.K. Certifikatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për V.D.K. e datës 14.10.2021; Certifikatë nga NDI për V.D. e muajit Dhjetor 2008; Certifikatë nga Britanica për V.D.; Certifikatë nga Britanica për V.D.; Certifikatë nga HSAC për V.D. i datës 20.06.2003; Certifikatë nga HSAC për V.D. i datës 27.03.2003; Rekomandim nga ISPE për V.D. i datës 26.05.2011; Referencë nga KQZ për V.D. i datës 26.05.2011; Rekomandim për V.D. i datës 11.10.2011; Pasqyra e Notave për V.D. e datës 07.09.2011; Leter Referencë për V.D. i datës 26.05.2011; Periudha e Vlerësimit Janar Dhjetor 2019 për V.D. i datës 27.12.2019; Periudha e Vlerësimit Janar Dhjetor 2020 për V.D. i datës 23.12.2020; Dëshmi nga trusti për V.D.K. i datës 20.06.2009-20.10.2021; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ për V.D. i datës 25.10.2021; CV-ja e A.O.; Dëshmi nga

trusti për A.O. i datës 20.01.2009-20.10.2021; Vërtetim nga Civita për A.O.; Letër Referencë për A.O. e datës 29.10.2014; Vërtetim nga JEOF për A.O.; Kontratë e Konsulentit për A.O. e datës 30.06.2017; Vërtetim nga KEC për A.O.; Certifikatë për A.O. e vitit 2019; Certifikatë nga JEF për A.O. i datës 15.09.2013; Certifikatë nga ASK për A.O. i datës 13.06.2017; Certifikatë për A.O. i datës 01.04.2018; Certifikatë e A.O. e muajit Shtator 2018; Certifikatë nga JEF për A.O. e muajit Shtator 2012; Certifikatë e A.O. e datës 14.02.2012; Certifikatë e A.O. e datës 03.02.2012; Diplomë nga BYO për A.O. e datës 08.04.2012; Certifikatë nga KAS për A.O. e datës 26.08.2012; Certifikatë për A.O. e datës 13.11.2011; Certifikatë nga YPC për A.O. i datës 30.06.2012; Certifikatë nga JEF për A.O. e datës 02.10.2011; Certifikatë për A.O. i datës 23.03.2014; Certifikatë nga KAS për A.O. i datës 16.09.2012; Certifikatë nga ASK për A.O. i datës 16.02.2017; Certifikatë për A.O. e muajit Maj 2008; Certifikatë për A.O. i datës 20.01.2017; Certifikatë nga Kolegji Universum për A.O. i datës 20.05.2017; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ për A.O. i datës 25.10.2021; Kërkesa për punësim e A.J. i datës 31.10.2021; CV-ja e A.J.; Diplomë me numër Nr.215/45-64 i datës 13.11.2015; Certifikatë nga Cisco për A.J. i datës 20.01.2016; Kontratë e Punës e A.J. e datës 03.06.2021; Letër promovimi e A.J. i datës 25.07.2020; Kontratë e Punës e A.J. e datës 03.06.2020; Kontratë e Punës e A.J. i datës 03.12.2018; Letër informimi për A.J. i datës 11.10.2018; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar i A.J. i datës 01.06.2018; Vërtetim nga SKQZ për A.J. i datës 15.03.2018; Referencë Pune për A.J. i datës 05.01.2018; Referencë Pune për A.J. i datës 23.05.2016; Shkresë nga UBT për A.J. i datës 31.07.2013; Certifikatë nga Gjykata Themelore Prizren për A.J. i datës 15.10.2021; Dëshmi nga trusti për A.J. i datës 18.10.2014-18.10.2021; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ për A.J. i datës 21.10.2021; Kërkesa për punësim e D.S. i datës 21.10.2021; CV-ja e D.S.; Letër Motivuese për D.S.; Letër Rekomandim për D.S. i datës 26.03.2021; Letër Rekomandim për D.S. i datës 27.12.2019; Shkresë për D.S.; Letër Referencë për D.S. i datës 19.01.2021; Referencë për D.S. i datës 29.03.2021; Diplomë me numër Nr.344/20 i datës 11.03.2020; Diplomë me numër Nr.1830/17 i datës 03.11.2017; Certifikatë nga Kolegji AAB për D.S. i datës 23.09.2017; Certifikatë për D.S. i datës 27.10.2018; Vërtetim nga Instituti AAB për D.S. i datës 06.03.2018; Certifikatë nga Gjykata Themelore Prizren për D.S. i datës 19.10.2021; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ për D.S. i datës 21.10.2021; Kërkesa për punësim e R.K. i datës 25.10.2021; CV-ja e R.K.; Certifikatë nga KQZ për R.K.; Letër Referencë për R.K. i datës 07.06.2021; Vërtetim për R.K. i datës 21.02.2021; Diplomë me numër nr.2027 i datës 15.11.2013; Diplomë me numër nr.1020 i datës 05.03.2018; Shkresë nga gap për R.K. i datës 15.04.2019; Vërtetim për R.K. i datës 22.05.2017; Letër Rekomandim për R.K. i datës 26.04.2018; Vërtetim për B.K. i datës 29.03.2021; Vërtetim për R.K. i datës 08.06.2021; Referencë zyrtare për R.K. i datës 31.12.2015; Certifikatë për R.K. i datës 03.06.2012; Vërtetim për praktikën e kryer për R.K. i datës 05.05.2013; Letër Referencë për R.K. i datës 13.02.2018; Certifikatë nga Gjykata Themelore Pejë e R.K. i datës 13.10.2020; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i Personelit SKQZ për R.K. i datës 25.10.2021; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 10.02.2022; Kërkesa për punësim e B.M. i datës 24.10.2021; Diplomë me numër nr. 4001 i datës 02.06.2015; Certifikatë për B.M. i datës 26.08.2015; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për B.M. i datës 01.07.2013; Certifikatë nga Gjykata Themelore Mitrovicë për B.M. i datës 22.10.2021; Certifikatë për B.M. i datës 23.08.2015; Certifikatë për B.M. i datës 20.04.2020; Certifikatë për B.M. i datës 27.07.2016; Dëshmi nga trusti për B.M. i datës 20.10.2012-20.10.2021; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 10.02.2022; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 11.02.2022; Vendim me nr.252-2022 i datës 10.02.2022; Kërkesa për punësim e L.K. i datës 21.10.2021; Dëshmi nga trusti për L.K. i datës 13.11.2002-18.10.2021; Certifikatë e Notave e

L.K. me nr.ref.12/11992 i datës 27.09.2016; Vërtetim për kryerjen e praktikës për L.K. i datës 13.01.2017; Vërtetim nga SKQZ për L.K. e vitit 2021; Vërtetim nga SKQZ për L.K. e vitit 2019; Vërtetim nga SKQZ për L.K. e datës 31.12.2017; Vërtetim nga SKQZ për L.K. e datës 10.07.2014; Certifikatë nga IKAF për L.K i datës 24.04.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar sepse:*

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit Lirik Krasniqi se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit përpara se të bëhet njoftim zyrtar për kandidatin e shpallur fitues, ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe në kundërshtim me Udhëzim Administrativ (KQZ) - Nr. 02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi që ka shqyrtuar ankesën e ankuesit pa pasur një akt final administrativ siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se në konkursin e shpallur të datës 11.10.2021 nga Komisioni Qendror Zgjedhor, për pozitën "Zyrtar i Lartë i Listës Votuese" në Prishtinë, ankuesi Lirik Krasniqi ka qenë kandidatë në këtë procedurë.

Po ashtu, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Komisionit Qendror Zgjedhor, për pozitën e shpallur "Zyrtar i Lartë i Listës Votuese", pas përfundimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, në bazë të Raportit Final të Rekomandimit të datës 26.11.2021 i ka rekomanduar Menaxheres së Personelit se kandidati Lirik Krasniqi duhet të emërohet në këtë pozitë në bazë të meritës pasi që ishte vlerësuar me 85 pikë dhe ishte renditur i pari.

Ndërsa, kandidati Labinot Binakaj i cili ishte pjesë e procedurave të konkurrimit për pozitën në fjalë me datë 30.11.2021 ka parashtruar ankesë në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror Zgjedhor me pretendimet ankimore për shkeljet procedurale administrative dhe procedurës së rekrutimit dhe mos zbatimin e së drejtës meritore sipas parimeve të përcaktuara ligjore për rekrutim për pozitën "Zyrtar i Lartë i Listës Votuese", ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 30.12.2021 ka nxjerrë vendimin me numër: 3549-2021 me konstatimin se ka gjetur shkelje procedurale pasi që testi me shkrim i datës 18.11.2021 nuk është në harmoni me parimet dhe dispozitat e përcaktuara me Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe punës provuese te nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mbi këtë bazë e kanë aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit

të datës 30.11.2021 ndërsa në pikën III të dispozitivit e ka obliguar institucionin që të bëjë anulimin e procedurës së rekrutimit, andaj Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datën 06.01.2022, ka nxjerr Vendimin me numër protokolli:06-2022 dhe ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën në fjalë.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Lirik Krasniqi, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve neni 49 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: "1. Kur një nëpunës ose kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një personi tjetër në atë pozite nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsive në zbatimin e rregullave dhe procedurave, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit, i cili e shqyrtou dhe vendos për ankesën. 2. Ankesat duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve nga data në të cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet nga institucioni përkatës", si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", ndërsa mbi bazën e shkresave të lëndës Institucioni që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit respektivisht Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka publikuar asnjëherë akt administrativ apo njoftim lidhur me kandidatin fitues siç përcaktohet me nenin 33 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku përcaktohet se: "Personeli njofton me shkrim kandidatin/et e suksesshëm lidhur me rezultatin e tij dhe faktin se është përzgjedhur për emërim në Sekretariat. 2. Personeli është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në tabelat për shpallje në objektin e KQZ-se dhe në ueb faqen e KQZ-se. Njoftimi përmban enurat e kandidateve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe piket e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes" ndërsa raporti i rekomandimit i datës 26.11.2021 është dokument i brendshëm dhe jo për publikë siç përcaktohet me nenin 32 paragrafi 2 i Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve : "Pas përfundimit të testimeve me shkrim dhe me gojë, kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës përgatit për Personelin një raport me shkrim, me të cilin e njofton Udhëheqësin e Personelit mbi rezultatet e konkursit për përzgjedhjen e kandidateve dhe rekomandimin e kandidatit/ëve për emërim, Forma. KQZ-R-11", andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 30.11.2021 pa u plotësuar kushti apo para se të ketë njoftim publik për vendimin e përzgjedhjes për kandidatin e suksesshëm siç parashihet me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka vepruar në kundërshtim si edhe me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", andaj vendimi i datës 30.12.2021 me numër:3549-2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror Zgjedhor është vendim i paligjshëm siç përcaktohet edhe me Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative" pasi që vendimmarrja e këtij Komisioni është përcjell me shkelje procedurale administrative të vetë rregullores së brendshme si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji në bazë të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka parashtruar me datë 30.11.2021 ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka nxjerrë vendimin me numër: numër:3549-2021 i cili është protokolluar me datë 30.12.2021 mirëpo në pjesën e preambulës është specifikuar se vendimi është nxjerrë me datë 29.12.2021, andaj me qëllim të qartësimit se cila llogaritet data e saktë e nxjerrjes së vendimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, respektivisht nenit 5 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 i cili përcakton se: *"Aktet e pranuar dhe të ndara protokollohen në evidencën themelore, me numër të protokollit në të njëjtën ditë në të cilën janë pranuar, me përjashtim kur: 1.1. Aktet e caktuara për të cilat kërkohet përgjigje në afat të shkurtuar duhet protokolluar para akteve të tjera dhe menjëherë duhet dërguar njësisë përkatëse për t'i pranuar. 1.2. Nëse për shkak të numrit të madh të akteve të pranuar ose për shkaqet e tjera të arsyeshme nuk mund të protokollohen në të njëjtën ditë kur janë pranuar, atëherë do të protokollohen më së voni ditën e ardhshme para se të pranohen aktet e reja"* dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAP) NR. 01/2017 për Administrimin e Punës në Zyrë, Evidencat Themelore dhe Detyrat e Punës së Arkivistit, mbi këtë bazë meqenëse nuk ka arsyetim sipas dispozitave të lartcekura, atëherë protokollimi i vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër: numër:3549-2021 është protokolluar ditën e pranimit pra me datë 30.12.2021, rrjedhimisht dita e protokollimit të dokumentacionit konsiderohet datë kur akti është valid, andaj mbi këtë bazë dëshmohet se ky vendim është nxjerr jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh siç përcaktohet me nenin 9 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ (KQZ) - Nr. 02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku përcaktohet se: *"Komisioni duhet të marrë vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës"* si dhe në kundërshtim me nenin 135 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Përpos kur ligji parashtron një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe ujustohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vendimin e ka nxjerr jashtë afateve procedurale administrative dhe përbënë shkak ligjor që ky vendim si i tillë të shfuqizohet siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"*, pasi që i njëjti është i paligjshëm dhe si i tillë nuk duhet të prodhojë efekte juridike në dëm të ankuesit.

Kolegji me rastin e vlerësimit të shkresave të lëndës e ka pasur parasysh faktin se ankuesi Labinot Binakaj me datë 01.12.2021 e ka bërë plotësimin e ankesës së datës 30.11.2021 të parashtruar në komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mirëpo Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk e ka përcaktuar se plotësimi i ankesës brenda afatit për zgjedhjen e saj nga organi kompetentë nuk shërben si parakusht për shtyrjen e afatit vendimmarrës prej 30 ditësh siç përcaktohet në nenin 135 paragrafi 1 të këtij ligji.

Andaj, Kolegji në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj"* si dhe në pajtim me nenin 55

paragrafi 1 të ku përcaktohet se: "Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë", e ka shfuqizuar po ashtu edhe Vendimin me numër:06-2022 të datës 06.01.2022 i Kryeshefit Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor për anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar i Listës Votuese" me numër reference KQZ-32/2021, meqenëse i njëjti është nxjerrë mbi bazën e vendimit të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i cili si në arsyetim të këtij vendimi është konstatuar se është i kundërligjshëm dhe i njëjti po ashtu është shfuqizuar me qëllim të kthimit të ligjshmërisë për rastin konkret.

Andaj pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe veprimeve procedurale administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror Zgjedhor, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror Zgjedhor, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër 3549-2021 të datës 30.12.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në kundërshtim me Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuase të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ (KQZ) - Nr. 02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA A.NR.60/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankauesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

